

Kush e ofron ndihmën juridike të garantuar nga shteti?

1. Ndihma juridike parësore ofrohet nga:

- Juristët (punonjësit me trajnim të posaçëm) pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore;
- Organizatat jofitimprurëse të autorizuar;
- Klinikat e Ligjit pranë Universiteteve;

Kliko linkun më poshtë për më shumë informacion mbi vendndodhjen dhe mënyrën se si të kontaktoni me këto struktura:

<https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/ndihma-juridike-paresore/>

2. Ndihma juridike dytësore ofrohet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë. Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore paraqitet pranë gjykatës ose organit procedues që fillon hetimet.

Kliko linkun më poshtë për të konsultuar listën e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore:

<https://www.drejtesia.gov.al/ndihma-juridike-e-garantuar-nga-shteti/>

Për më shumë informacion ju mund të vizitoni faqen online të **Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas** në linkun: <https://ndihmajuridike.gov.al/> ose mund t'i drejtoheni personalisht/ elektronikisht ose me anë të shërbimit postar Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas:




Adresa: Rruga "Jordan Misja" Godina nr. 3, Tiranë
E-mail: dnjf@drejtesia.gov.al

Gjithashtu, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka vendosur në dispozicion të publikut një numër të gjelbër pa pagesë **0800 10 10** dhe një sistem online **"Juristi Online"** nga ku mund të përfitoni nga ndihma juridike parësore falas.

Kjo fletëpalosje u hartua në bashkëpunim me Institutin Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (Qendra ALTRI), me mbështetjen financiare të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.



NDIHMA JURIDIKE E GARANTUAR NGA SHTETI: NJË E DREJTË THEMELORE



Çfarë është ndihma juridike falas?

“Ndihma juridike” është shërbimi juridik falas i cili garantohet dhe financohet nga shteti për të gjithë individët, pjesë e kategorive vulnerabël dhe/ose me të ardhura të pamjaftueshme, të cilët nuk kanë mundësi t'i drejtohen një juristi apo avokati për të zgjidhur problematikën e tyre ligjore.

Për këtë qëllim, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 111/2017, Ministria e Drejtësisë ka krijuar Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, që mundëson ofrimin e ndihmës juridike përmes juristëve/avokatëve falas.

Kush mund të përfitojë nga ky shërbim?

Çdokush që ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për këshillim, përfaqësim dhe/ose mbrojtje ligjore në çështjet penale, administrative dhe ato civile.

Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre:

- viktimave të dhunës në familje;
- viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore;
- viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin;
- fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- personave me aftësi të kufizuara ose të verbrit;
- personave me probleme të shëndetit mendor;
- personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;
- personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent.

Çfarë shërbimesh përfitoni nga kjo ndihmë?

1. Ndihmë juridike parësore, që është dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk kërkojnë përfaqësim në gjykatë (si, dhënia e informacionit apo këshillimit ligjor, dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike, përfaqësimi përpara organeve administrative, dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit);

2. Ndihmë juridike dytësore, që është këshillimi, përfaqësimi dhe mbrojtja para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe penale.

3. Përfshirjen nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit) dhe/ose nga parapagimi i tarifës së ekzekutimit të vendimit pranë shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror.